

QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Për sigurimin e një pune të ligjshme, të ndershme, transparente dhe të përgjegjshme të anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, zëvendësministrave dhe bartësve të funksioneve publike të emëruar nga Qeveria, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mbledhjen e mbajtur më 22 shtator 2020, miratoi:

KODIN E SJELLJES ETIKE PËR ANËTARËT E QEVERISË DHE BARTËSIT E FUNKSIONEVE PUBLIKE TË EMËRUAR NGA QEVERIA

(tekst i konsoliduar – version jozyrtar)¹

PJESA I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Lënda e rregullimit të Kodit

Neni 1

Me këtë Kod rregullohet mënyra e sjelljes dhe e punës së Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, ministrave, zëvendësministrave dhe bartësve të tjerë të funksioneve ekzekutive të emëruar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: bartës të funksioneve ekzekutive), për të siguruar respektimin e kushtetutshmërisë, ligjshmërisë, integritetit profesional, efikasitetit, lojalitetit, përgjegjësisë, transparencës dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut gjatë ushtrimit të funksioneve, përkatësisht detyrave të tyre, në kuadër të Kushtetutës, ligjeve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

¹ Teksti i konsoliduar i Kodit të sjelljes etike për anëtarët e Qeverisë dhe bartësit e funksioneve publike të emëruar nga Qeveria përfshin: tekstin bazë të Kodit, të shpallur në “Gazetën Zyrtare të RMV-së”, nr. 232, të datës 27.9.2020, dhe Kodin për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit të sjelljes etike, të shpallur në “Gazetën Zyrtare të RMV-së”, nr. 162, të datës 16.7.2021.

Teksti i konsoliduar nuk ka fuqi juridike.

Për qëllime juridike, të vlefshme janë vetëm tekstet e shpallura në Gazetat Zyrtare të përmendura më sipër të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Qëllimi i Kodit

Neni 2

Qëllimi i Kodit është sigurimi i forcimit të integritetit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, ministrive dhe organeve të tjera të administratës shtetërore, si dhe i personave juridikë të themeluar nga Qeveria (në tekstin e mëtejme: institucionet), dhe forcimi i besimit të qytetarëve në punën e tyre.

Emërimi i anëtarit të Qeverisë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Kodit

Neni 2-a

Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut emëron një anëtar të Qeverisë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të këtij Kodi, për promovimin e sjelljes në përputhje me Kodin dhe për monitorimin e respektimit të tij nga bartësit e funksioneve ekzekutive (në tekstin e mëtejme: anëtar i Qeverisë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Kodit).

Për këshillim mbi zbatimin praktik të dispozitave të këtij Kodi, nga anëtar i Qeverisë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Kodit emërohet një person përgjegjës për këshillim për zbatimin praktik të dispozitave të këtij Kodi, çështjet etike dhe integritetin (në tekstin e mëtejme: personi për këshillim për zbatimin e dispozitave të Kodit), i cili publikohet në faqen e internetit të Qeverisë.

PJESA II

PARIME THEMELORE

Parime dhe standarde themelore

Neni 3

Bartësit e funksioneve ekzekutive, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre, i përmbahen parimeve themelore të këtij Kodi dhe standardeve të sjelljes, siç janë:

- shteti i së drejtës,
- realizimi i interesit publik,
- respekti i ndërsjellë dhe mbrojtja e reputacionit të Qeverisë dhe institucioneve,
- bashkëpunimi, efikasiteti dhe ekonomia,
- llogaridhënia, transparenca dhe përgjegjshmëria,
- përfshirja, orientimi drejt konsensusit dhe
- përgjegjësia.

Parimi i shtetit të së drejtës

Neni 4

Bartësit e funksioneve ekzekutive i ushtrojnë autorizimet dhe detyrat e tyre publike në përputhje me Kushtetutën, ligjet, rregulloret e tjera të miratuara në bazë të ligjit dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Bartësit sigurojnë që të gjithë ata që punojnë nën juridiksionin e tyre të jenë njësoj përgjegjës para Kushtetutës dhe ligjit, dhe që Kushtetuta dhe ligjet të zbatohen njësoj për të gjithë.

Parimi i realizimit të interesit publik

Neni 5

Bartësit e funksioneve ekzekutive në punën e tyre i përkushtohen ekskluzivisht interesit publik dhe së mirës së përgjithshme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe qytetarëve të saj.

Bartësit e funksioneve ekzekutive nuk mund ta përdorin pozicionin e tyre për përfitim personal ose përfitim të personave të afërt, si dhe për përfitim të një partie politike apo subjekti tjetër.

Bartësit e funksioneve ekzekutive vendosin marrëdhënie besimi dhe bashkëpunimi me qytetarët dhe personat juridikë, duke treguar mirëkuptim, mirësjellje dhe vullnet për të ndihmuar, e jo për të penguar realizimin e të drejtave dhe interesave të tyre.

Bartësit e funksioneve ekzekutive i përmbahen parimit të drejtësisë dhe qëllimshmërisë gjatë ushtrimit të autorizimeve të tyre diskrecionale.

Bartësit e funksioneve ekzekutive i përmbahen ndalesave të përcaktuara në ligje dhe në këtë Kod.

Parimi i respektit të ndërsjellë dhe mbrojtjes së reputacionit të Qeverisë dhe institucioneve

Neni 6

Bartësit e funksioneve ekzekutive në punën e tyre sillen në mënyrë profesionale dhe ruajnë standardet më të larta të sjelljes, përkatësisht tregojnë kujdes dhe respekt të veçantë ndaj personalitetit dhe reputacionit të çdo individi.

Bartësit e funksioneve ekzekutive kujdesen që me sjelljen e tyre të mos dëmtojnë interesin apo reputacionin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejshëm: Qeveria) dhe institucioneve që drejtojnë ose në drejtimin e të cilave marrin pjesë.

Bartësit e funksioneve ekzekutive shprehin lirshëm dhe hapur qëndrimet lidhur me politikat e propozuara, por i mbështesin në mënyrë solidare politikat dhe vendimet qeveritare pasi ato të miratohen dhe, në paraqitjet e tyre publike, i prezantojnë politikat në përputhje me këtë Kod.

Bartësit e funksioneve ekzekutive respektojnë autorizimet e personave të tjerë të zgjedhur dhe të emëruar dhe të punësuarve në sektorin publik, ndaj të cilëve sillen në përputhje me këtë Kod.

Parimi i bashkëpunimit

Neni 7

Në drejtim të parimit të realizimit të interesit publik, bartësit e funksioneve ekzekutive bashkëpunojnë ndërmjet vete, si dhe me bartës të tjerë të funksioneve publike.

Parimi i efikasitetit dhe economicitetit

Neni 8

Bartësit e funksioneve ekzekutive i zbatojnë në mënyrë racionale dhe me kohë detyrat dhe autorizimet e tyre dhe i përdorin me maturi burimet publike për arritjen e qëllimit të funksionit apo detyrës që ushtrojnë, ndërsa qytetarët kanë rezultate të matshme në raport me mjetet dhe punën e investuar.

Bartësit e funksioneve ekzekutive kujdesen që qytetarët të mos ekspozohen ndaj shpenzimeve të panevojshme gjatë realizimit të të drejtave, obligimeve dhe interesave të tyre.

Parimi i llogaridhënies, transparencës dhe përgjegjshmërisë

Neni 9

Bartësit e funksioneve ekzekutive japin rregullisht llogari për punën dhe sjelljen e tyre, si dhe për punën e institucionit që drejtojnë ose në drejtimin e të cilit marrin pjesë, para publikut, Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Bartësit e funksioneve ekzekutive sigurojnë qasje në informacione me karakter publik në përputhje me ligjin, përkatësisht i informojnë me kohë, plotësisht dhe në mënyrë proaktive publikun për punën e tyre ose të institucionit, në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, në formë të shkruar dhe elektronike, në faqen e internetit të institucionit.

Bartësit e funksioneve ekzekutive përgjigjen në mënyrë jo selektive, me kohë dhe të argumentuar ndaj pyetjeve dhe komenteve të publikut dhe palëve të interesuara për të gjitha aspektet e punës së tyre dhe punës së institucionit të tyre.

Parimi i përfshirjes dhe orientimit drejt konsensusit

Neni 10

Në procesin e zhvillimit, zbatimit dhe vlerësimit të politikave publike, bartësit e funksioneve ekzekutive zbatojnë të gjitha format legjitime të pjesëmarrjes dhe i përfshijnë të gjitha palët e interesuara.

Gjatë zhvillimit, zbatimit dhe vlerësimit të politikave publike bartësit e funksioneve ekzekutive angazhohen për harmonizimin e interesave të ndryshme në shoqëri me qëllim arritjen e një konsensusi të gjerë për vendimet që do të jenë në interes të të gjithëve, pa dallim të përkatësisë etnike apo partiake, gjinie, orientimi seksual, identiteti gjinor, race, ngjyre lëkure, prejardhjeje, përkatësie në grupe të marginalizuara, gjuhe, origjine shoqërore, arsimi, feje, bindjeje politike apo tjetër, aftësie të kufizuar, moshe, gjendjeje familjare apo martesore, statusi i pasurisë, gjendjeje shëndetësore, tipari personal dhe statusi shoqëror, përkatësisht në interes të shoqërisë në tërësi.

Parimi i përgjegjësisë

Neni 11

Bartësit e funksioneve ekzekutive janë personalisht përgjegjës për punën e institucionit që drejtojnë ose në drejtimin e të cilit marrin pjesë, si dhe për punën e institucioneve mbi të cilat ushtrojnë mbikëqyrje, përkatësisht për vendimet dhe veprimet e tyre gjatë mandatit dhe për zbatimin e këtij Kodi.

Bartësit e funksioneve ekzekutive janë personalisht përgjegjës për sjelljen e tyre në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe këtë Kod, para Kryetarit të Qeverisë dhe para Kuvendit.

Kryetari i Qeverisë, ministrat (në tekstin e mëtejshëm: anëtarët e Qeverisë) dhe zëvendësministrat janë lojalë ndaj Qeverisë dhe mbajnë përgjegjësi kolektive për miratimin e vendimeve qeveritare dhe për zbatimin e politikave qeveritare, dhe punojnë së bashku me anëtarët e tjerë të Qeverisë për të arritur koherencë dhe harmonizim në vendimmarrje.

Ministrat dhe zëvendësministrat janë lojalë ndaj Kryetarit të Qeverisë me propozimin e të cilit janë emëruar. Anëtarët e Qeverisë dhe zëvendësministrat janë të pranishëm në seancat e Kuvendit gjatë shqyrtimit të ligjeve dhe akteve e materialeve të tjera nga kompetenca e tyre dhe në seancat për pyetje të deputetëve, duke iu përgjigjur pyetjeve lidhur me ushtrimin e kompetencave të tyre, përfshirë edhe pyetjet për mënyrën dhe qëllimin e shpenzimit të mjeteve nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

PJESA III

RREGULLA TË SJELLJES

Shmangia e konfliktit të interesit publik dhe privat

Neni 12

Bartësit e funksioneve ekzekutive, gjatë ushtrimit të autorizimeve dhe detyrave të tyre, shmangin çdo lloj konflikti ndërmjet interesit publik dhe privat, përkatësisht çdo situatë që mund të krijojë dyshim për ekzistencën e një konflikti interesi. Bartësit e funksioneve ekzekutive, gjatë ushtrimit të autorizimeve dhe detyrave, veçanërisht kujdesen për respektimin e Kushtetutës, Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit dhe Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve dhe rregullave të tjera, si dhe të sigurojnë mekanizma për respektimin e tyre nga ana e të gjithë të punësuarve në institucionin me të cilin udhëheqin.

Bartësit e funksioneve ekzekutive, funksionin e ushtrojnë si detyrë kryesore dhe të vetme, përkatësisht nuk guxojnë të ushtrojnë veprimtari tjetër që mund të ndikojë mbi ushtrimin e paanshëm të autorizimeve dhe detyrave të tyre, dhe duhet t'i përmbahen në mënyrë konsekuente dispozitave të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit mbi:

- ndalimin e ushtrimit të veprimtarive të tjera,
- kufizimet për ushtrimin e veprimtarisë gjatë kryerjes së funksionit, - kufizimin e ushtrimit të mbikëqyrjes,
- kufizimin për ushtrimin e veprimtarisë pas përfundimit të funksionit,
- ndalimin për anëtarësim në organe drejtuese dhe mbikëqyrëse,
- ndalimin për keqpërdorimin e të dhënave zyrtare,
- kufizimet në bashkëpunim me persona juridikë,
- ndalimin për përdorimin e huave dhe llojeve të tjera të mbështetjes nga shteti,
- disponimin e pronës shtetërore,
- përdorimin ekonomik të mjeteve shtetërore,
- ndalimin e fitimit të të drejtave të aksionarëve,
- ndalimin e ndikimit për punësimin e të afërmeve të ngushtë, dhe
- ndalimin e ndikimit mbi procedurat e prokurimeve publike.

Bartësit e funksioneve ekzekutive janë vazhdimisht të disponueshëm dhe të angazhuar për qëllimet e punës edhe jashtë orarit të punës, për shkak të së cilës mund t'i përdorin pajisjet elektronike, lidhjet telefonike ose të internetit që u janë ndarë për qëllime zyrtare.

Ndarja e interesave shtetërore nga ato partiake — pjesëmarrja në aktivitete partiake gjatë mandatit

Neni 13

Bartësit e funksioneve ekzekutive, gjatë pjesëmarrjes në aktivitete partiake si anëtarë dhe bartës të funksioneve në parti politike, kandidimit ose përfaqësimit në parti dhe kandidatëve për zgjedhje lokale, parlamentare ose presidenciale, nuk guxojnë të rrezikojnë profesionalizmin dhe disponueshmërinë e ushtrimit të funksionit, përkatësisht detyrës, dhe gjithmonë prioritet do të ketë funksioni publik, përkatësisht detyra.

Bartësit e funksioneve ekzekutive, jashtë orarit të punës të institucionit me të cilin udhëheqin, mund të marrin pjesë në aktivitete partiake si anëtarë të partive politike, të jenë kandidatë ose të përfaqësojnë parti dhe kandidatë për zgjedhje lokale, parlamentare dhe presidenciale, por nuk guxojnë të rrezikojnë profesionalizmin dhe disponueshmërinë e funksionit, përkatësisht detyrës që ushtrojnë, me ç'rast gjithmonë prioritet do të ketë funksioni, përkatësisht detyra që ushtrojnë.

Bartësit e funksioneve ekzekutive të cilët kanë qëllim të marrin pjesë në zgjedhje, pas konfirmimit nga komisioni kompetent zgjedhor për kandidat sipas Kodit Zgjedhor, duhet të njoftojnë me shkrim Kryetarin e Qeverisë dhe anëtarin e Qeverisë përgjegjës për ndjekjen e zbatimit të Kodit.

Marrëdhëniet me lobistët

Neni 14

Bartësit e funksioneve ekzekutive, gjatë kontakteve me lobistët dhe organizatat lobuese, respektojnë në mënyrë të përpiktë Ligjin për Lobimin.

Bartësit e funksioneve ekzekutive, gjatë kontakteve me lobistët dhe organizatat lobuese, kur janë objekt i lobimit:

- kujdesen që të mos vijnë në gjendje të konfliktit të interesit; i kanë parasysh qëllimet e lobimit që kryen lobisti, përkatësisht organizata lobuese që i kontakton; në situatë të konfliktit të interesit gjatë lobimit, e ndërpresin kontaktin dhe refuzojnë çfarëdo kontakti të mëtejshëm me lobistin, përkatësisht organizatën lobuese dhe përfaqësuesin e organizatës lobuese; përgatisin procesverbal, i cili përmban informacion për lëndën e diskutimit dhe identitetin e personave që kanë qenë prezentë; publikojnë kopje të procesverbalit në faqen e internetit të institucionit me të cilin udhëheqin;
- publikojnë informacione për takimet me lobistët dhe informacione për kontakte të realizuara me palë të treta, përkatësisht palë të tjera të interesuara.

Marrëdhëniet me punonjësit në sektorin publik

Neni 15

Bartësit e funksioneve ekzekutive respektojnë profesionalizmin dhe paanshmërinë e të punësuarve në sektorin publik, me ç'rast nën asnjë kusht nuk do t'i vënë ata në situatë të sjelljes në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik, Ligjit për nëpunësit administrativë, ligjeve të tjera, marrëveshjeve kolektive, Kodit për nëpunësit administrativë dhe kodeve të institucioneve në të cilat punojnë.

Bartësit e funksioneve ekzekutive, me sjelljen e tyre ndaj të punësuarve në institucionin me të cilin udhëheqin, përkatësisht në udhëheqjen e të cilit marrin pjesë, sillen me respektin e duhur ndaj personalitetit të tyre dhe nuk do të ndikojnë mbi ta në mënyrë që është në kundërshtim me ligjin.

Bartësit e funksioneve ekzekutive, gjatë punësimit, avancimit dhe ndërprerjes së marrëdhënies së punës në institucionin me të cilin udhëheqin, udhëhiqen nga kriteret e profesionalizmit dhe kompetencës dhe zbatimit të parimit të përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të pjesëtarëve të bashkësive dhe aftësive profesionale të kandidatëve dhe të punësuarve në institucionin me të cilin udhëheqin, si dhe kujdesen për perspektivën gjinore.

Bartësit e funksioneve ekzekutive kanë parasysh argumentet dhe këshillat profesionale të të punësuarve gjatë përgatitjes dhe marrjes së vendimeve dhe zbatimit të politikave qeveritare.

Bartësit e funksioneve ekzekutive nuk do të ushtrojnë ndikim mbi të punësuarit në sektorin publik për t'u anëtarësuar në çfarëdo shoqate, organizate ose partie, e as nuk do t'i shantazhojnë ata me avancim në karrierë, dhe nuk mund të kërkojnë, as të presin praninë ose pjesëmarrjen e të punësuarit në aktivitetet e një partie politike.

Prezantimi i politikave

Neni 16

Bartësit e funksioneve ekzekutive nuk mund të paraqiten vetëm në emrin e tyre personal, ndërsa deklaratat e dhëna, paraqitjet si të ftuar, intervistat, postimet në rrjetet sociale duhet të jenë konsistente me politikën qeveritare dhe programin e përcaktuar të punës së Qeverisë.

Nëse nga bartësit e funksioneve ekzekutive kërkohen komente dhe deklarata për çështje që janë në kompetencë të një institucioni tjetër dhe për të cilat përgjegjësi ka një bartës tjetër i funksionit ekzekutiv, ata konsultohen me bartësin e funksionit ekzekutiv, në kompetencën e të cilit është çështja.

Bartësit e funksioneve ekzekutive, përpara se të japin deklaratë që ka të bëjë me qëllimet strategjike të Qeverisë dhe për politika që nuk janë miratuar, konsultohen me Kryetarin e Qeverisë.

Bartësit e funksioneve ekzekutive janë të paanshëm dhe neutralë ndaj të gjithë pjesëmarrësve në sferën mediatike dhe respektojnë lirinë e paprekshme të mediave.

Profilët zyrtarë në mediat sociale të institucioneve dhe të bartësve të funksioneve ekzekutive janë burimi parësor për komunikimin e politikave, programeve, njoftimeve dhe iniciativave qeveritare.

Në postimet në profilet e mediave sociale, në të cilat bartësit e funksioneve ekzekutive paraqiten në emër të institucioneve, nuk duhet të promovohen aktivitete dhe simbole partiake.

Pranimi i dhuratave

Neni 17

Bartësit e funksioneve ekzekutive gjatë ushtrimit të funksioneve dhe detyrave nuk mund të pranojnë dhurata, përveç në rastet, në vlerën dhe në mënyrën e përcaktuar me Ligjin për shfrytëzimin dhe disponimin me sendet në pronësi shtetërore dhe sendet në pronësi komunale dhe Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit.

Bartësit e funksioneve ekzekutive nuk guxojnë të kërkojnë, të pranojnë, përkatësisht të lejojnë që një person tjetër në emër të tyre ose në dobi të tyre të japë ose të pranojë dhuratë, shërbim ose çfarëdo vlere tjetër, ndihmë apo dobi tjetër në lidhje me ushtrimin e funksionit, përkatësisht detyrës, e cila do të mund të kishte ndikim ose në çfarëdo mënyre të komprometonte gjykimin e tyre ose t'i vendoste ata në varësi dhe obligim të papërshtatshëm.

Bartësit e funksioneve ekzekutive nuk duhet të pranojnë dekorata, medalje, çmime ose nderime nga shtete të huaja ose organizata të huaja gjatë ushtrimit të funksionit ose detyrës së tyre, dhe në rast të nderimeve të tilla, ata duhet të konsultohen me Ministrinë e Punëve të Jashtme në lidhje me pranimin e nderimeve për secilin rast veç e veç.

Përdorimi i burimeve materiale — integriteti i funksionarëve në shpenzime dhe kompensime

Neni 18

Bartësit e funksioneve ekzekutive sigurojnë menaxhim dhe përdorim maksimalisht efektiv dhe ekonomik të mjeteve materiale, pajisjeve dhe sendeve të tjera që u janë besuar, dhe parandalojnë disponimin e tyre të paligjshëm, kujdesen për marrjen e masave të duhura për sigurimin e sigurisë së sendeve të besuara, si dhe për eliminimin e mundësive për shkaktimin e dëmit material në organin me të cilin udhëheqin.

Bartësit e funksioneve ekzekutive, hapësirat qeveritare dhe shtetërore, inventarin, mjetet financiare dhe teknike që u janë vënë në dispozicion në lidhje me ushtrimin e funksionit, i përdorin me ndërgjegje dhe përgjegjësi dhe ekskluzivisht për ushtrimin e funksionit.

Bartësit e funksioneve ekzekutive, çdo gjashtë muaj, i dorëzojnë anëtarit të Qeverisë të caktuar si përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Kodit, raporte për shpenzimet zyrtare të bëra gjatë ushtrimit të autorizimeve dhe detyrave të tyre publike, përveç në situatat kur shpallja publike e këtyre informacioneve mund të paraqesë rrezik për sigurinë. Për monitorim më të lehtë dhe llogaridhënie para qytetarëve, të gjitha raportet janë publikisht të disponueshme përmes një zgjidhjeje softuerike për paraqitjen dhe vizualizimin e shpenzimeve zyrtare në faqen zyrtare të internetit të Qeverisë.

Udhëtimet

Neni 19

Bartësit e funksioneve ekzekutive gjatë udhëtimeve të organizuara për qëllime private ose partiake nuk guxojnë t'i mbulojnë ato me mjete shtetërore, as të përdorin privilegjet që rrjedhin nga autorizimet dhe detyrat (pasaporta diplomatike, sigurimi dhe shoferi/automjeti zyrtar) për qëllime private ose partiake, përveç rasteve kur i njëjti nuk i nënshtrohet masave speciale të sigurisë.

Bartësit e funksioneve ekzekutive gjatë udhëtimeve zyrtare për obligime profesionale jashtë vendit udhëhiqen nga parimi i efikasitetit dhe ekonomizimit dhe sigurojnë aranzhimet ekonomikisht më të pranueshme.

Bartësit e funksioneve ekzekutive janë personalisht përgjegjës për madhësinë dhe përbërjen e delegacioneve zyrtare për udhëtim jashtë vendit dhe të njëjtat duhet të jenë sa më të vogla që të jetë e mundur, duke siguruar ndërkohë parakushtet e nevojshme për përmbushjen e duhur të qëllimeve të udhëtimit.

Në rrethanat kur bartësi i funksionit ekzekutiv në udhëtimin e tij zyrtar jashtë vendit shoqërohet nga bashkëshorti/ja ose partneri/ja, ai/ajo udhëton ekskluzivisht me shpenzime private. Kjo nuk përfshin bashkëshortin/en ose partnerin/en e Kryetarit të Qeverisë kur udhëton si pjesë e delegacionit zyrtar.

Bartësit e funksioneve ekzekutive nuk mund të pranojnë udhëtime dhe akomodime që nuk janë të paguara nga mjetet e dedikuara për atë qëllim, përveç kur bëhet fjalë për pjesëmarrje në ngjarje zyrtare, takime dhe konferenca me ftesë ose ngjarje të tjera të karakterit diplomatik apo protokollar.

PJESA IV

ZBATIMI I KODIT DHE PËRGJEGJËSIA PËR MOSRESPEKTIMIN E DISPOZITAVE TË KODIT

Deklarata për respektimin e Kodit

Neni 20

Bartësit e funksioneve ekzekutive do të nënshkruajnë një deklaratë me shkrim, me të cilën konfirmojnë se do t'i përmbahen këtij Kodi gjatë ushtrimit të autorizimeve, përkatësisht detyrave të tyre.

Dorëzimi i raportit

Neni 21

Anëtari i Qeverisë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Kodit, çdo gjashtë muaj nga emërimi i tij dhe në afat prej 10 ditësh para përfundimit të mandatit të Qeverisë, i dorëzon Kryetarit të Qeverisë një raport për respektimin e Kodit nga bartësit e funksioneve ekzekutive.

Raportimi i dyshimit për konflikt interesi

Neni 22

Me kërkesë të anëtarëve të Qeverisë, zëvendësministrave dhe funksionarëve të tjerë të emëruar nga Qeveria, me iniciativë personale ose pas marrjes së informacionit, personi për këshillim mbi zbatimin e Kodit, do t'i këshillojë ata për çdo lloj çështjeje të sjelljes dhe çështje etike që lidhet me këtë Kod dhe do të japë rekomandime të përgjithshme për veprim të mëtutjeshëm.

Bartësit e funksioneve ekzekutive bashkëpunojnë me anëtarin e Qeverisë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Kodit dhe i vënë në dispozicion të gjitha informacionet relevante që ai do t'i kërkojë, përveç atyre që kanë karakterin e informacioneve të klasifikuara.

Bartësit e funksioneve ekzekutive menjëherë, e më së voni në afat prej tri ditësh nga dita e kryerjes ose marrjes së njohurisë për mosrespektimin e dispozitave të këtij Kodi, informojnë Kryetarin e Qeverisë dhe anëtarin e Qeverisë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Kodit, në rast të ekzistimit të dyshimit që lidhet me zbatimin e këtij Kodi gjatë ushtrimit të funksionit, përkatësisht detyrës.

Masat në rast të mosrespektimit të Kodit

Neni 23

Në rast të mosrespektimit të dispozitave të këtij Kodi, anëtari i Qeverisë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Kodit, e paralajmëron me shkrim bartësin e funksionit ekzekutiv se ka shkelur Kodin dhe i bën me dije që në afat prej tri ditësh nga dorëzimi i vërejtjes ta përmirësojë sjelljen.

Nëse bartësi i funksionit ekzekutiv, në afatin nga paragrafi 1 i këtij neni, nuk e përmirëson sjelljen, anëtar i Qeverisë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Kodit, i dorëzon mendim Kryetarit të Qeverisë, në bazë të të cilit Kryetari i Qeverisë mund të vendosë të zbatojë njërën nga masat në vijim:

- Kritikë zyrtare në publik për sjelljen e personit që nuk e ka respektuar këtë Kod dhe udhëzim për përmirësimin e sjelljes, me ç'rast e njëjta mund të publikohet edhe në faqen e internetit të Qeverisë;
- Përgjegjësi politike, përkatësisht kërkesë për dorëheqjen e bartësit të funksionit ekzekutiv ose propozim për shkarkimin e tij dhe/ose;
- Ngritjen e iniciativës për informimin e institucioneve kompetente, më së voni në afat prej një muaji nga dita e marrjes së njohurisë për mosrespektimin e këtij Kodi, ligji, veçanërisht Ligjit, veçanërisht Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit, Ligjit për mbrojtjen e denoncuesve dhe Ligjit për lobimin.

-

Zbatimi i dispozitave të Kodit për këshilltarët

Neni 24

Ky Kod do të zbatohet në mënyrë përkatëse edhe për këshilltarët, sekretarët dhe ndihmës-sekretarët në sekretariatet e Zyrës së Kryetarit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilët i emëron Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, si dhe për këshilltarët e posaçëm të angazhuar nga ministrat, të cilët gjatë nënshkrimit të kontratës për angazhimin e tyre, nënshkruajnë edhe deklaratën për pranimin e këtij Kodi.

PJESA V

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE DHE KALIMTARE

Neni 25

Me ditën e shpalljes së këtij Kodi, pushon së zbatuari Kodi i sjelljes etike për anëtarët e Qeverisë dhe bartësit e funksioneve publike të emëruar nga Qeveria ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 176/19).

Neni 26

Ky Kod shpallet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".